



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI PORTUAL DURRËS

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “BLERJE GOMA PER TERMINALIN E KONTEINERËVE DHE SHËRBIM NDËRRIM GOMASH DHE KONVERGJENCE” (Procedurë e Hapur- Mall) mbi kufirin e larte monetar

**VLERA E FONDIT LIMIT: 24.000.000 (njëzet e katër milion) Leke pa TVSH**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Goma për automjete të rënda / të lehta	34350000-5
Goma për automjete të rënda	34352000-9
Shërbime konversioni automjeteve dhe reconditioning	50117000-8
Riparim dhe renovim	45453000-7

Afati i lëvrimin do jetë **12 (dymbëdhjetë) muaj** nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër.

**FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.*

**Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (sipas shtojcës 8).

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së i ndryshuar, nenin 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

## 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre vitet e fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit Udhëzim i Përgjithshëm. nr. 26, datë 8.9.2023 për tatimin mbi të ardhurat, Ligj nr. 29/2023 për tatimin mbi të ardhurat. Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përllogaritur te fondit të limit të kësaj kontrate

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik ose **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në nenin 40, pika 4 dhe neni 47, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësor. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

### 2.3.2 Certifikim i Operatorit Ekonomik

*Të jetë i pajisur me Çertifikatë ISO 9001:2015, (për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë), e vlefshme ose ekuivalente.*

*Të jetë i pajisur me Çertifikatë ISO 14001:2015 (Sistemi i Manaxhimit Mjedisor) e vlefshme ose ekuivalente.*

*(Certifikatat duhet te jete te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te cilat jane te akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).*

**Argumentimi:** *Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”; si dhe nenin 44 të V.K.M-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

### 2.3.3 Oferta Teknike

- a. Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për te gjitha mallrat ne formatin e Ofertes Teknike, në formën e një table sipas modelit të mëposhtëm, e cila duhet të plotësohet në mënyrë rigoroze. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë;

- Emri i kompanisë prodhuese
- Emërtimi i Katalogut të prodhuesit ose i skedës teknike
- Numri i faqes në katalog ose në skedën teknike ku ndodhet artikulli
- Numri (kodi) identifikues i artikullit të ofruar, i shënuar me një shenjë dalluese

Të dhënat e deklaruara në ofertën teknike duhet të korespondojnë me të dhënat për artikujt në katalogët/skedat teknike të dorëzuara. Moskorespondimi i këtyre të dhënave do të sjellë pavlefshmëri të ofertës.

**Argumentim:** *Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në*

*lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, eshte vendosur në përputhje me piken 6, te Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*

**2.3.4** Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standardet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit/ve per listen e mallrave objekt prokurimi, ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen.

**Shenim:** Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

**Argumentim:** *Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, eshte vendosur në përputhje me piken 6/b, te Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*

### **2.3.5 Mbi fuqine punetore**

- a. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë një punësim mesatar i të paktën 6 (gjashte) personave, të cilët duhet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimumi per 6 (gjashte) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:
  - Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave
- b. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të punësuar (per kete sherbim), të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme.
  - 4 (kater) punonjës gomist me pervoje pune jo me pak se 6 muaj

Për përmbushjen e këtij kriteri OE duhet të paraqesin:

- Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi minimumi per 6 (gjashtë) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave
- CV

**Kriteret mbi fuqinë punëtore, të nevojshme përmbushen me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.**

**Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzoje dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.**

**Argumentim:** *Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri*

kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Numri është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e kontratës. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

### 2.3.6 PAJISJE DHE INSTRUMENTA

- a) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë pajisjet e mëposhtme të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira/ huapërdorje të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës:

<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i pajisjes</b>	<b>Sasia</b>
1.	Pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave nga disku i rrotës për mjete industriale	Jo më pak se 2 copë
2.	Pajisje për kontrollin dhe balancimin e disqeve dhe gomave për mjete industriale	Jo më pak se 2 copë
3.	Sistem konvergjence për kamiona	Jo më pak se 1 copë
4.	Krik për ngritjen e mjeteve të rënda ≥80 Ton Mjeteve Industriale	Jo më pak se 1 copë

Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për pajisjet teknike të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe të verifikueshme modeli me të dhënat e tyre të cilat vërtetohen me:

- Skede Teknike të pajisjeve dhe instrumentat për mjetet e rënda
- Pajisjet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose fature blerje.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

### **Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.**

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- b) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë Mjetet e mëposhtme të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira/ huapërdorje të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës:

<i>Nr.</i>	<i>Përshkrimi i Mjetit</i>	<i>Sasia</i>
1.	Mjet gomisteri e levizshme	Jo më pak se 2 copë

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjetin gomisteri të lëvizshme për kryerjen e ndërrimit dhe transportimit të gomave. Për të vërtetuar këtë fakt, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat origjinale të mjetit që disponon dhe pronësinë e tij, shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Nqs mjeti është me qera, duhet të paraqitet kontrata e qiramarrjes e cila duhet të jetë e noterizuar.

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (qoftë në pronësi apo dhe me qira) duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik, siguracion dhe taksat vjetore.
- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë foto të mjetit të lëvizshëm, ku të dallohet qartë targa e mjetit dhe pajisjet e brendshme për ndërrimin e gomave për mjete e renda.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

**Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.**

**Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.**

### **2.3.7 Servis (Gomisteri për Mjete Industriale)**

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin objekt kontrate duhet të ketë

- Në pronësi ose kontratë shërbimi një pikë servisi, gomisteri për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës
- Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik duhet të paraqesë aktin e pronësisë ose me qira të objektit /kontraten e noterizuar me servisin,
- Pergjegjes teknike të aktivitetit të autoriparimit
- Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë noteriale të vlershme me pergjegjesin teknike.
  - Dëshmi e aftësie Profesionale për veprimtarinë e autoriparimit Kodi VII.3.B.1.
    - Riparimi dhe mirëmbajtja e gomave të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e 4 Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga

*fakti se shërbimi, objekt prokurimi është Sherbim nderrim gomash, vlerësohet e nevojshme që operatori ekonomik duhet të disponojë një ambient për kryerjen e këtij shërbimi dhe të gjitha proceseve të punës, që ky shërbim përfshin, si: Montim, cmontim te gomave, balancim te disqeve dhe gomave, konvergjenca, riparim ventili, vendosje pulle, etj. Disponimi minimalisht i 1 (një) ambjenti ku ushtron aktivitetin e tij, siguron AK që shërbimi i nderrimit te gomave, objekt prokurimi, do të kryhet në kohë, cilësi dhe konform kushteve. Udhëzimi Nr. 1546, datë 29.03.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove*

### **Argumentimi i marrëveshjes kuadër:**

1. Marrëveshja kuader do të lidhet me një operator ekonomik pasi janë të përcaktuara të gjitha kushtet kryesore të tilla si: artikujt, specifikimet e sakta teknike, afatet e lëvrimit, si dhe sasitë që priten të furnizohen.
2. Nga përvoja e prokurimit të artikujve (objekt i kësaj procedure) në vite, çmimet e tregut kanë rezultuar të jenë të qendrueshëm dhe nuk ndryshojnë.
3. Në rast se kjo marrëveshje do të lidhej me disa OE do të shkaktonte kosto shtesë dhe vështirësi autoritetit kontraktor si p.sh mospërputhje të artikujve të dhënë në bazë të rendit, pjesë të tyre të përbashkëta.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

### **KUSHTET PER TU ZBATUAR NE PRANIM.**

**A. Në fazen e pranimit, janë të detyruar të paraqesin;**

1. **Dokumente origjinale** ose te njevlefshme, te deklaruar ne institucionet tona zyrtare, me ane te te cilave te demonstrohet, se sherbimet jane kryer Referuar ANEX-I me ate te paraqitura ne dokumentet e ofertimit.
2. **Dokumente origjinale** ose te njevlefshme, te deklaruar ne institucionet tona zyrtare, me ane te te cilave te demonstrohet produktet e ofruara

### **VERIFIKIMI DOKUMENTEVE TE DOREZUARA**

**AUTORITETI KONTRATOR,** rezervon te drejten te kryeje, te gjitha verifikimet qe i konsideron te nevojshme, per tu garantuar mbi vlefshmerine e dokumenteve te kerkuara.

### **ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

*Specifikimet teknike jane hartuar duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per mallrat objekt procedure prokurimi, duke perlogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, ne perputhje me parashikimet e nenit 4 ,pika38/b dhe nenit 36,te LPP,i ndryshuar,si dhe nenit 40,pika 1 dhe 2, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimin publik” te ndryshuar.*

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin*

e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

#### Argumentimi mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit pa e ndarë në lote:

Autoriteti Portual Durrës është duke zhvilluar procedurën e prokurimit me titull "**Blerje goma për terminalin e konteinerëve dhe shërbim ndërrim gomash dhe konvergjence**". Megjithatë, në përputhje me nenin 39, pika 1, të LPP “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe me nenin 42, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kjo procedure nuk është ndarë në lote për arsyet e mëposhtme: Kjo procedurë prokurimi nuk është ndarë në lote, pasi objekti i prokurimit përbën një tërësi funksionale dhe teknike, ku artikujt janë të ndërlidhur me njëri-tjetrin dhe përbëjnë një grup të vetëm të pandashëm për realizimin e qëllimit përfundimtar të kontratës. Ndarja në lote do të sillte rrezik për mospërputhje të artikujve dhe specifikimeve teknike ndërmjet operatorëve të ndryshëm ekonomikë, duke vështirësuar ndjeshëm realizimin e kontratës në tërësi.

Gjithashtu, ndarja në lote do të shkaktonte kosto shtesë administrative për autoritetin kontraktor dhe do të rëndonte procesin e ndjekjes dhe zbatimit të kontratës, për shkak të nevojës për të koordinuar disa kontrata të ndryshme për të njëjtin objekt. Kjo do të krijonte vështirësi në menaxhimin e afateve të dorëzimit, cilësisë së produkteve dhe përputhshmërisë teknike ndërmjet loteve të ndryshme.

Për këto arsye, vlerësohet se realizimi i objektit të kësaj procedure është më efikas dhe më i leverdishëm financiarisht duke u trajtuar si një i tërë, pa e ndarë në lote.

#### **KOMISIONI I PERCAKTIMIT TE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PERLLOGARITJES SE VLERES SE FONDIT LIMIT**